

KONTRATE

E lidhur me date: 28.05.2019.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"Eko Ing" Sh.p.k-Prizren (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Vendosja dhe mirembajtja e ndriqimit te qytetit ne Dragash
me numër Identifikues **621-19-2251-2-3-6**, dhe nr, te brendshem **621-2019-032-236**

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Vendosja dhe mirembajtja e ndriqimit te qytetit ne Dragash** 1.2 Kontrata hynë në fuqi me **28.05.2019**, dhe përfundon **15 dite pune nga data e urdherdhjenjes per sherbimin ose deri me date 20.06.2019.**

1.3 Afat kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së shërbimeve] do të jetë **ne Dragash**

1.5 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6. Menagjer i kontrates **Bean Haxhiasani**

1.6. Menagjer i projektit(sherbimit) **Florim Krasniqi**

1.7. Menagjer i projektit nga ana e Operatorit Ekonomik: **Diamant Selaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit

Opština Dragash

03 Nr. Br. 400-8179

28.05.2019

Dragash - Dragash

Neni 2 **Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Cmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **3,272.50 €; (tre mij e dyqind e shtatedhjet e dy Euro e pesedhjete cent).**

3.2 Cmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përpunhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[shërbimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit *[shërbimeve]*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] / të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet/ [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë. Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 **Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspekojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 **Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paalësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 **Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën themelore ne Prizren, dega ne Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14

Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	“ Eko Ing” Sh.p.k- Prizren	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:		Pozita:	Zyrtar perqejës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.05.2019. SH.P.K.	Data:	28.05.2019.
Vula:		Vula:	

Për Autoritetin Kontraktues



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij

Numri i Prokurimit: 621-19-2251-2-3-6 – Titulli Vendosja dhe mirëmbajtja e ndriqimit të Qytetit - Dragash

Sekcioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ⁶ - €	Çmimi total €	Koha dërges
1.	Shenimi i lokacionit dhe vendosja e masave te sigurese gjate punimeve.	paushall	1	50	50.00	
2.	Germimi i dheut per hapjen e gropave per vendosjen e shtyllave , si dhe largimi i dheut .	cop	3	5	15.00	
3.	furnizimi , transporti dhe vendosja e gypave nga betonarmeja per bazen e shtyllese , logaritur me matrejalin dhe punimet e tjera te nevojeshme.	cop	3	30	90.00	
4	furnizimi , transporti dhe montimi i shtyllave nga betoni per vendosjen e trupave ndriqus , logaritur edhe vendosjen e togezimit dhe punimet e tjera.	cop	3	180	540.00	
5	furnizimi , transporti dhe montimi kabllit 3x2.5 dhe montimi i trupave ndriqus .	m'	550	0.05	27.50	
6	furnizimi , transporti dhe montimi i mbajteseve te trupave ndriquese , nga konstruksioni metalik	cop	25	10	250.00	
7	Furnizimi,transporti dhe montimi i llampave ndriquese te qytetit. Lampa duhet te jete LED me paisjet per montimin ne shtylla(drurit,betonit,metalike). Lampa ne aspektin e dizajnit dhe kualitetit duhet te i plotesoje standarde Europiane: EN60598-2.Class I/II Elektrikal,mbrojtje mekanike: IP65(IP66),afat te cendruesherise se punes te garantuar me shume se 50000 h dhe me frekuencë 50Hz,po ashtu me temperature pune prej -40° deri ne +60°,me eficiencë te drites ≥ 150 lm/W si dhe fuqia e lampes duhet te jete 85 v-260v., 50/60 hz	cop	25	80	2,000.00	
8	Riparimi i trupave ndriqus ekzistus perforsimi ,shatngimi dhe funksionalizimi i tyre .	cop	15	20	300.00	
Totali i Përgjithshëm:					3,272.50	

⁶ Detyrimi i Dorëzimit është Paguari- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare